

SALI KADRIA

**FILLESAT E ORGANIZATËS SË FSHEHTË POLITIKE
“KRAHU KOMBËTAR” (KLIKA) – LARGIMI I AHMET ZOGUT
PREJ SAJ**

Abstrakt:

Artikulli synon të japë një vështrim të përgjithshëm rreth organizatës politike “Krahu Kombëtar” (Klika), e cila ishte mjaft aktive gjatë viteve 1920, si dhe të paraqesë kontributin e drejtuesve të saj për organizimin e Kongresit të Lushnjës dhe në ringritjen e strukturës së shtetit shqiptar në fillim të viteve 1920. Autori përpiqet të hedhë dritë në lidhje me qëllimin dhe kohën e formimit të saj; të trajtojë modelin e kësaj organizate, programin politik si dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të saj. Në artikull pasqyrohen emrat e drejtuesve të parë të saj si dhe arsytet e angazhimit të Ahmet Zogut në këtë organizatë politike në mbarim të Luftës së Parë Botërore. Aty trajtohen shkaqet dhe rrethanat që çuan në ftohjen e marrëdhënieve të “Klikës” me Ahmet Zogun, duke nisur nga pranvera e vitit 1923, si dhe rrethanat e largimit të Ahmet Zogut nga “Klika” në fillim të zgjedhjeve për në Asamblenë Kushtetuese të Shqipërisë.

Fjalë kyçe:

“Krahu Kombëtar” (Klika), Shqipëria, Ahmet Zogu, Eshref Frashëri, Sejfi Vllamasi, Rexhep Mitrovica, “Partia Popullore”, “Partia Përparimtare”, kompania britanike “Anglo-Persian Oil”, Asamble Kushtetuese.

**Zanafilla e organizatës së fshehtë politike
“Krahu Kombëtar” (Klika)**

Një kontribut të rëndësishëm në ndërtimin e shtetit shqiptar gjatë viteve 1920 dha organizata e fshehtë politike “Krahu Kombëtar”. Përpjekjet për themelimin e saj nisën qysh në pranverë të vitit 1914. Sabri Qyteza njoftonte opinionin publik shqiptar për mbajtjen së shpejti të “një mbledhjeje të përgjithshme në një qytet që të pëlqenet prej gjithë anëvet, ku të formohet Partija me një program të pëlqyerë nga shumica e

patriotëvevet”.¹ Nismëtarët e kësaj organizate u përpoqën të vepronin sipas modelit të organizatës xhonturke “Bashkim e Përparim”. Duke ndjekur këtë model, një pjesë e nacionalistëve shqiptarë vendosën të themelonin një organizatë të fshehtë politike që vepronte brenda administratës së shtetit shqiptar. Me sa duket, formimi i saj u realizua edhe me mbështetjen e Austro-Hungarisë.²

Organizata e fshehtë politike u themelua në Durrës nga një grup nacionalistësh, më 28 qershor 1914.³ Nismëtarë të formimit të “Krahut Kombëtar” ishin: Eshfref Frashëri, Ali Shefqeti, Xhavit Leskoviku, Halim Gostivari, Rexhep Mitrovica, Sejfi Vllamasi dhe Sotir Peci.⁴ Në fillim, organizata u quajt “Lidhja për Thronin e Atdheun”, ndërsa më vonë mori emërtimin “Krahu Kombëtar” ose “Klika”. Ajo ishte një nga organizatat e para politike dhe ndër më të rëndësishmet që u formuan në Shqipëri pas Shpalljes së Pavarësisë.⁵

Në momentin e themelimit të saj, kjo organizatë nacionaliste kishte për qëllim shpëtimin e atdheut nga veprimtaria politike e Esat Pashë Toptanit, të cilën e cilësonin si antikombëtare; mbrojtjen e Shqipërisë nga synimet e Italisë dhe të shteteve fqinje; si dhe mbështetjen e Princ Vidit e të qeverisë shqiptare në rrethanat e vështira të krijuara në këtë kohë.⁶ Përfaqësuesit e saj synonin të kundërshtonin kryengritjen e kujtdo që nuk e dëshironte shtetin shqiptar si dhe t’i jepnin për të kuptuar opinionit publik se nacionalizmi shqiptar kërkonte një “qeverie më atdhedashëse”, e cila duhej të përbëhej nga shqiptarë të ndershëm kombëtarë, të çliruar nga ndikimi i huaj.⁷

¹ Sabri Qyteza, “Bashkohuni o Nacionalistë”, në *Liri e Shqipërisë*, nr. 95, Sofje, 9/22 qershor 1914, f. 3. Shkrim i dërguar nga Durrësi, më 30 mars/17 prill 1914.

² Ali Këlcyra, *Shkrime për Historinë e Shqipërisë*, përgatitur nga Tanush Frashëri, Tiranë: Onufri, 2012, f. 85.

³ *Arkivi Qendror i Shtetit i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F) 32, Viti (më tej: V) 1914, Dosja (më tej: D) 163, fl. 58-59, “Statut-irregullore e Lidhjes Për Thronin e Për Atdheun [hartuar] prej një grupi Nacionalistash, korrik 1914”.

⁴ Lush Culaj, *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” 1918-1924*, botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prishtinë: GME, 1997, f. 21-22.

⁵ Letër e Mustafa Krujës për Stavro Skëndin, Ramleh (Egjipt), 2 nëntor 1953, në *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, Tiranë: 1996, f. 116; Terenc Toçi, (M. Shini), *Çastja financjare n’ Shqypnii*, Shkodër: Taraboshi e C. T. R., 1914, f. 14.

⁶ Fejzi Alizoti, *Kujtimet e jetës sime politike, 1891-1921*, Tiranë: Albas, 2012, f. 84; T. Toçi, (M. Shini), *Çastja financjare...*, f. 11-12.

⁷ “Gjendja e punëve në Shqipëri”, në *Dielli*, Boston, Mass., 19 qershor 1914, f. 2; T. Toçi, (M. Shini), *Çastja financjare...*, f. 11-12.

Organizata “Lidhja për Atdheun e për Thronin” (Krahu Kombëtar) vepronte në fshehtësi të madhe dhe mbliidhej vetëm për çështje shumë të rëndësishme. Ajo drejtohej nga dy organe kryesore: Këshilli kombëtar dhe Komisioni drejtues. Këshilli i “Lidhjes për Atdheun e për Thronin” (Krahu Kombëtar) përbëhej nga 22 anëtarë, në të cilin bënë pjesë figura të spikatura nacionaliste, si: dom Nikollë Kaçorri, dr. Ibrahim Temo, Abdyl Ypi, Mustafa Kruja, dr. Fahri Gjilani, Luigj Gurakuqi, Refik Toptani, Eshref Frashëri, Izet Zavalani, Loni Logori, G. Jatro, Themistokli Gërmenji, Idhomeno Kosturi, Sejfi Vllamasi, Ahmet Dakli, Shefqet Daiu, Kostë Paftali, Nuri Vila, Grigor Cilka, I. Kasneci, Syrja Pojani dhe Hasan Frashëri. Këshilli i “Lidhjes për Atdheun e për Thronin” zgjodhi një komision drejtues prej pesë anëtarësh, i përbërë nga Eshref Frashëri, Luigj Gurakuqi, Mustafa Kruja, Abdyl Ypi dhe Idhomeno Kosturi. Ky komision ishte ngarkuar me detyrën e ekzekutimit të vendimeve të dhëna. Komisioni i mësipërm kishte detyrë kryesore zbatimin me çfarëdo mjeti të vendimeve të Këshillit të organizatës “Lidhja për Atdheun e për Thronin”. Kjo organizatë politike përgjigjej vetëm përpara qeverisë shqiptare.⁸ Anëtarët e saj zgjidheshin pas një shqyrtimi të kujdesshëm me propozim të themeluesve dhe me miratim të Këshillit. Anëtarët e rinj nuk kishin të drejtë të ndryshonin çështjet thelbësore të programit të kësaj organizate. Anëtarët e saj shpreheshin se do të vepronin si një trup i vetëm në mbrojtje të shtetit, si dhe do të derdhnin gjakun e tyre për “atdheun” dhe “mbretin”. Ata duhej të jepnin prova se ishin njerëz të vlefshëm dhe qëndronin të patundur për veprim dhe therori.⁹

“Krahu Kombëtar” hartoi një program politik dhe ekonomik për zhvillimin e vendit.¹⁰ Kjo organizatë përcaktoi si detyrë kryesore, eliminimin e çdo pengese që shkonte kundër ideologjisë kombëtare dhe forcimit të shtetit shqiptar. Synimi i saj ishte bashkimi i forcave kombëtare në një grupim politik të përbashkët. Kjo shënoi përpjekjen e parë serioze të vënies në zbatim të ideologjisë kombëtare për ngritjen e shtetit shqiptar pas Shpalljes së Pavarësisë, por njëherësh tregoi edhe dobësinë e nacionalizmit shqiptar. Kjo organizatë nuk arriti të shpëtonte shtetin shqiptar nga rreziqet me të cilat u ndesh, për shkak se në këtë

⁸ *AQSH*, F. 32, V. 1914, D. 163, fl. 61. Letër e major A. Shevketit, drejtuar Simon Dodës, 27 gusht 1914.

⁹ T. Toçi, (M. Shini), *Çastja financjare...*, f. 12-13.

¹⁰ *Po aty*, f. 14-15.

periudhë, numri i nacionalistëve ishte i vogël në raport me masën e popullsisë.¹¹ Grupimi i nacionalistëve përbëhej kryesisht nga të rinj nga jugu i Shqipërisë, të cilët ishin pa përvojë politike. Në rrethanat e asaj periudhe, ky grupim politik nuk i pati mjetet dhe mundësitë e duhura për të ushtruar një ndikim më të madh në mesin e shqiptarëve. Për rrjedhojë, elita nacionaliste nuk qe në gjendje t'i jepte vendit drejtimin e duhur politik, ekonomik dhe social.¹² Duke synuar modernizimin e shpejtë të vendit dhe të shoqërisë shqiptare, veprimet e saj nxitën padashur mosbesim në masën e popullsisë.¹³

Pas largimit të Princ Vidit nga Shqipëria, në fillim të shtatorit 1914, për shkak të përndjekjes nga kryengritësit fanatikë myslimanë shqiptarë, një grup prej afro 35 nacionalistësh shkuan në Shkodër.¹⁴ Në këtë qytet u mbledhën Aqif Pashë Elbasani, Refik Bej Toptani, Fuad Bej Toptani, Kara Seit Pasha, Bajram Curri, Isa Boletini, Bajram Daklani si dhe shumë shqiptarë nga Kosova, të cilët po planifikonin organizimin e një kryengritjeje kundër Serbisë. Ata mendonin se sapo të hynin në viset që mbaheshin nga Serbia, do të mbështeteshin nga rreth 8 mijë shqiptarë të Kosovës.¹⁵

Anëtarët e “Krahut Kombëtar”, të cilët u vendosën në Shkodër, hynë në lidhje me Hoxhë Kadriun (Kadri Prishtina) si dhe u informuan mbi nismën dhe punën e zhvilluar prej tij për formimin e një komiteti të fshehtë kombëtar me qendër në këtë qytet. Ata e informuan Kadri Prishtinën për ecurinë dhe vendimet që ishin marrë në Durrës, për themelimin e organizatës “Krahu Kombëtar”, si dhe i kërkuan atij që t'i bashkohej organizatës së tyre. K. Prishtina vendosi të pranonte ftesën e paraqitur.¹⁶

¹¹ Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, Tiranë: Phoenix, 1998, f. 247.

¹² “Gabimet”, në *Besa Shqiptare*, nr. 37, Shkodër, 9 shtator 1914, f. 1-2.

¹³ “Shënime e Kuitime. Essad-Ehlikiam e Kombtarë”, në *Populli*, nr. 56, Shkodër, 20 maj 1915, f. 2.

¹⁴ Nikollë Ivanaj, *Historija e Shqipëniës së Re – vujejtjet e veprimet e mija*, Pjesa e Parë, Tiranë: Atdheu, 1943, f. 57; L. Culaj, *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” 1918-1924 ...*, f. 22.

¹⁵ *Haus - Hof und Staats Archiv, Wien Politisches Archiv Albanien*, (më tej: *HHStA.PA. A*), në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 25-4-485. Telegram i ambasadorit austro-hungarez Pallavicini, drejtuar ministrit të Jashtëm në Vjenë, Stamboll, 26 janar 1915.

¹⁶ L. Culaj, *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” 1918-1924...*, f. 22.

Në pranverë të vitit 1915, në Shkodër, u formua “Komiteti i Fshehtë” (pjesë e ish “Krahut Kombëtar”) me kryetar Hoxhë Kadriun.¹⁷ Kjo organizatë politike kishte synim mbrojtjen e çështjes kombëtare shqiptare, çlirimin e Kosovës nga forcat serbe dhe bashkimin e saj me shtetin shqiptar.¹⁸ “Komiteti i Fshehtë” u zgjerua me anëtarë të rinj, si: Koço Kotta, Lukë Luka, Salih Gjuka, Shefqet Korça dhe Bajram Fevziu. Drejtuesit e organizatës ngarkuan Sali Gjukën dhe Shefqet Korçën, me detyrën e përfshirjes në “Krahun Kombëtar” të anëtarëve të rinj si dhe me organizimin e procesit të betimit të tyre. Kjo organizatë politike mori me qira një shtëpi në qytetin e Shkodrës, në të cilën mbaheshin mbledhjet e Këshillit drejtues të saj. Në vijim, në “Krahun Kombëtar” u anëtarësuan Hamit Qulli, dr. Fahri Gjilani, Aqif Pashë Elbasani dhe Bajram Curri. Në të njëjtën kohë, u vendos krijimi i degëve të kësaj organizate në qytete të ndryshme të Shqipërisë.¹⁹

Pas hyrjes së trupave të Malit të Zi në Shkodër, në qershor 1915, u ndërpre veprimtaria e kësaj organizate politike. Nga muaji shtator 1915, për shkaqe sigurie, një pjesë e grupit nacionalist që ndodhej në Shkodër u vendos në Burgajet të Matit, ku vepronte Ahmet Zogu.²⁰ Një pjesë tjetër e tyre shkuan në SHBA. Ardhja e tyre e forcoi më shumë Federatën Panshqiptare “Vatra”, e cila u bë organizata më e fuqishme kombëtare shqiptare.²¹

Gjatë periudhës së okupimit austro-hungarez të Shqipërisë, nacionalistët shqiptarë u përpoqën t’u përshtateshin kushteve të reja të krijuara në vend. Ata u përpoqën të shfrytëzonin çdo mjet që patën në dispozicion në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare, duke synuar t’u shkëpusnin autoriteteve austro-hungareze sa më tepër të drejta kulturore. Figura të rëndësishme kombëtare shqiptare morën përsipër detyra në administratën lokale shqiptare që vepronte nën mbikqyrjen e autoriteteve ushtarake austro-hungareze. Prandaj, mund të thuhet se veprimtaria e organizatës “Krahu Kombëtar” u zhvillua aq sa lejonin rrethanat e luftës,

¹⁷ Eqber Skëndi, *Hoxhë Kadriu*, Prishtinë: Rilindja, 1992, f. 36.

¹⁸ “Nji vështrim mi gjendjen t’onë”, në *Populli*, nr. 50, Shkodër, 13 maj 1915, f. 1; Kristo Floqi “Kosova. Serbi e Vjetër!”, (Studim etnografik e statistik, përgjegje z. Prof. Zvijich-it), në *Agimi*, nr. 2, Shkodër, qershor 1920, f. 33-36.

¹⁹ L. Culaj, *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” 1918-1924 ...*, f. 22-23.

²⁰ N. Ivanaj, *Historija e Shqipëniës së Re...*, f. 63.

²¹ Beqir Meta, *Federata Panshqiptare “Vatra” (1912-1920)*, Tiranë: Globus R, 2001, f. 143.

sepse komanda ushtarake austro-hungareze kishte urdhëruar ndalimin e çdo lloj veprimtarie politike në territorin e okupuar prej saj.²² Prandaj, deri në mbarim të Luftës së Parë Botërore, “Krahu Kombëtar” mbeti në fazë embrionale.²³

Më 1 maj 1918, në Shkodër, u formua Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” nën drejtimin e Hoxhë Kadriut, i cili veproi në mënyrë ilegale deri më 7 nëntor të këtij viti.²⁴ Në vitet 1918-1920, kur Shkodra u vendos nën administrimin ushtarak të Fuqive Aleate, Hoxhë Kadriu, Bajram Fevziu, Sejfi Vllamasi, Sali Nivica dhe Ali Shefqeti, rifilluan veprimtarinë e fshehtë politike, pasi siguruan një leje të posaçme nga autoritetet ushtarake franceze të pushtimit. Në mesin e kësaj organizate u krijuan dy rryma politike. Rryma e parë, drejtohej nga Hoxhë Kadriu, e cila synonte formimin e një shteti shqiptar plotësisht të pavarur, mbështetur në mendimin se shqiptarët ishin në gjendje të drejtonin shtetin e tyre pa qenë nevoja e vendosjes së tij nën “protektoratin” e ndonjë fuqie fituese të luftës. Në rrymën e dytë, bënë pjesë Eshref Frashëri, Bajram Fevziu dhe Sejfi Vllamasi, të cilët u larguan nga Shkodra dhe u vendosën në Durrës, ku ranë në kontakt me Xhavit Leskovikun, Halim Gostivarin, Koço Kottën, Ali Shefqetin dhe Rexhep Mitrovicën. Në vitin 1919, “Krahu Kombëtar” vijoi të funksiononte si një komitet i fshehtë i ngjashëm me Komitetin “Bashkim e Përparim”, ku drejtues ishin Eshref Bej Frashëri, Sejfi Vllamasi dhe Rexhep Bej Mitrovica.²⁵

Numri i reduktuar i anëtarëve të organizatës së mbetur në Shkodër, ndikoi në kufizimin e veprimtarisë së saj në këtë qytet. Organizata

²² *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-6-631*. Telegram shifër i kontit Thurn, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 17 mars 1916.

²³ Syrja Vlora, *Kujtime – Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, përgatitur për botim dhe redaktuar nga Akad. assoc. Marenglen Verli dhe dr. Ledia Dushku, Tiranë: Iceberg, 2013, f. 180-181.

²⁴ *AQSH, F. 446, V. 1918, D. 1, fl. 1-2*. Programi themeltar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”; Zamir Shtylla, “Rreth krijimit dhe veprimtarisë së ‘KMKK’”, në *Studime historike*, nr. 3, ASH, Instituti i Historisë, Tiranë: 1986, f. 98.

²⁵ *The National Archives*, London (më tej: *TNA*), Foreign Office (më tej: *FO*) 371/ 7330. Telegram i Heathcote-Smith për markezimin Curzon të Kedleston, Durrës, 18 janar 1922; Mustafa Kruja – P. Paulin Margjokaj OFM, *Letërkëmbim (1947-1958)*, Shkodër: Camaj-Pipa, 2006, dok. nr. 20, f. 74; Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942 (Kujtime dhe vlerësime historike)*, përgatitur për botim nga prof. dr. Marenglen Verli, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 165.

“Krahu Kombëtar” që vepronte në Durrës rifilloi veprimtarinë politike, duke shtuar degët dhe numrin e anëtarëve të saj, ndër të cilët mund të përmenden Qazim Kokoshi dhe Qazim Koculi. Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” vijoi të bashkëpunonte me organizatën “Krahu Kombëtar”, përmes degës së këtij komiteti në Durrës, e cila drejtohej nga Halim Gosturani dhe Rexhep Mitrovica.²⁶

Në mbarim të Luftës së Parë Botërore, drejtuesit e “Krahit Kombëtar” Eshref Frashëri, Sejfi Vllamasi dhe Rexhep Mitrovica ishin të ndërgjegjshëm për faktin se ndryshe nga Shqipëria e Jugut, në të cilën kishin njëfarë ndikimi, ata do të ndeshnin vështirësi në Shqipërinë e Veriut, në sigurimin e mbështetjes politike për realizimin e synimeve të tyre politike. Në këto rrethana, atyre u duhej të gjenin njerëz të aftë dhe me influencë nga kjo pjesë e vendit.²⁷ Bashkëpunimi i Ahmet Zogut me këtë organizatë nisi në vitin 1917.

Pasi analizuan figurat kryesore shqiptare që kishin më tepër ndikim në Shqipërinë e Veriut, ata u gjendën para dilemës, për të zgjedhur mes Mustafa Krujës dhe Ahmet Zogut. Më në fund, drejtuesit e “Krahit Kombëtar” zgjodhën A. Zogun për disa arsye kryesore: *së pari*, ndryshe nga Mustafa Kruja, i cili njihej si mbështetës i politikës italiane dhe i idesë së protektoratit italian mbi Shqipërinë, Ahmet Zogu ishte për ruajtjen e sovranitetit politik të shtetit shqiptar; *së dyti*, drejtuesit e “Krahit Kombëtar” synonin të shfrytëzonin lidhjet dhe influencën personale që kishte A. Zogu në Shqipërinë e Veriut, si dhe forcën e armatosur që ai kishte pas vetes; *së treti*, ata menduan se krahasuar me Mustafa Krujën, i cili mbronte idenë e vendosjes së një balance më të drejtë të përfaqësimit midis Shqipërisë së Veriut dhe Jugut, në drejtimin politik të vendit, Ahmet Zogu ishte një njeri “i paditur”, i cili në të ardhmen mund të kthehej lehtësisht në një “vegël” të tyre. Mirëpo, ndryshe nga sa pritej, A. Zogu e përdori me shumë zgjuarsi “Klikën”, për të forcuar pozitën e tij politike në të gjithë vendin. Qysh në fillim të bashkëpunimit me këtë organizatë politike, ai e pati të qartë se pa një mbështetje të drejtuesve të “Klikës” kryesisht nga jugu i vendit, ai do ta kishte të vështirë të realizonte planet dhe ambiciet e tij politike.²⁸

²⁶ L. Culaj, *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” 1918-1924...*, f. 23-24.

²⁷ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 191.

²⁸ M. Kruja – P. P. Margjokaj OFM, *Letërkëmbim (1947-1958)*..., dok. nr. 20, f. 75; Eqrem bej Vlora, *Kujtime (1885-1925)*, përkthyer nga Afrim Koçi, Shtëpia e Librit &

Në takimin e mbajtur në Romë me përfaqësues të “Krahut Kombëtar”, në pranverë të vitit 1919, Ahmet Zogu, Fazli Frashëri dhe Sejfi Vllamasi ishin të një mendjeje, për fillimin sa më shpejt të punës, për përgatitjen e një kongresi kombëtar në Shqipëri, me qëllim shpëtimin e vendit nga rreziku që i kërcënohej. Që nga kjo periudhë, filloi angazhimi aktiv i Ahmet Zogut në këtë organizatë.²⁹

Gjatë viteve 1920-1924, “Krahu Kombëtar” u shfaq si një prej formacioneve politike më aktive në Shqipëri. Drejtuesit e kësaj organizate u bënë nismëtarët dhe organizatorët e Kongresit Kombëtar të Lushnjës të vitit 1920.³⁰ Meqenëse nuk arritën të mblidheshin në Elbasan, anëtarët e “Krahut Kombëtar” u morën vesh me sheh Ibrahim Karbunarën dhe me disa anëtarë të tjerë të kësaj organizate, për organizimin e kongresit në Lushnjë. Por, para se të merrej ky vendim, kapiten Meleq Frashëri shkoi në Berat dhe siguroi edhe pëlqimin dhe mbështetjen e Iljaz Vrionit për mbajtjen e Kongresit në Lushnjë.³¹

Kongresi i Lushnjës u dominua nga Ahmet Zogu, Aqif Pashë Elbasani dhe Eshref Frashëri. Ahmet Zogu u zotua se do ta mbronte kongresin, qoftë edhe me jetën e tij. Mënyra e mjeshtërore e sjelljes dhe metodat e veprimit të tij, bënë përshtypje tek të gjithë të pranishmit. Kontributi që pati në Kongresin e Lushnjës, si dhe guximi që tregoi për kalimin e sigurt të autoriteteve të zgjedhura në kongres, nga Lushnja në Tiranë, i siguruan A. Zogut një vend mbizotërues ndër kolegët e tij ministra, si dhe u bë një faktor i rëndësishëm në politikën shqiptare gjatë viteve 1920.³²

“Krahu Kombëtar” arriti rezultate të rëndësishme në zhvillimet politike dhe në themelimin e institucioneve kombëtare të shtetit të ri shqiptar.³³ Për shkak se kjo organizatë ishte më e unifikuar dhe vepronte në mënyrë konspirative, këto veçori i dhanë fillimisht “Krahut Kombëtar”

Komunikimit, Tiranë: 2003, f. 462; Mustafa Kruja, *Anthologji historike (Shkrime e përkthime)*, përpiluar nga Bashkim Merlika, Elbasan: Sejko, 2001, f. 295.

²⁹ M. Kruja – P. P. Margjokaj OFM, *Letërkëmbim (1947-1958)*..., dok. nr. 20, f. 75.

³⁰ A. Këlcyra, *Shkrime për Historinë e Shqipërisë*..., f. 66.

³¹ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942*, përgatitur për botim nga Marenglen Verli, Tiranë: Neraida, 2000, f. 190.

³² Marcellus Donald Alexander R. von Redlich, *Albania yesterday and today*, Worcester, Mass.: The Albanian Messenger, 1936, p. 61; Albana Mema, *Institucionet përfaqësuese në Shqipëri 1920-1924*, botim i Institutit të Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë: Kristalina-KH, 2021, f. 39.

³³ A. Mema, *Institucionet përfaqësuese në Shqipëri*..., f. 33.

një epërsi në arenën politike shqiptare. Më vonë, ajo shfaqti kufizimet e saj, të cilat patën pasoja negative për funksionimin e parlamentit dhe të institucioneve të shtetit shqiptar. Prania e një organizate të fshehtë, drejtuesit e së cilës vepronin në institucionet drejtuese të shtetit shqiptar, përbënte një anomali të madhe, në procesin e shtetformimit. Kjo organizatë u shndërrua në një pengesë kërcënuese për ekzistencën dhe funksionimin e institucioneve përfaqësuese politike legale.³⁴

Qysh në muajt e parë të aktivitetit shtetëror, grupimi nacionalist që doli nga Kongresi i Lushnjës, filloi të shfaqte shenjat e antagonizmit e të rivalitetit midis parisë dhe midis anëtarëve të “Krahut Kombëtar”. Me sa duket, arsyet e divergjencave të tyre ishin kryesisht të natyrës së interesave personalë. Krisja e parë ndodhi në mesin e “Krahut Kombëtar” gjatë vitit 1920, kur Aqif Pashë Elbasani u largua nga “Krahu Kombëtar”, për shkak të përkrahjes që ky grup i dha Ahmet Zogut.³⁵

Në këtë periudhë, krahas egoizmit individual dhe mosmarrëveshjeve klanore e individuale, u shfaqën edhe kundërshti politike parimore. Drejtuesit e Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, prisnin një mbështetje më të madhe nga ana e qeverisë shqiptare për çlirimin e Kosovës.³⁶ Me kërkesën e Hasan Prishtinës dhe Bajram Currit, nacionalisti italian Gabriele D’Annunzio dërgoi në Shëngjin, në verën e vitit 1920, dy anije të ngarkuara me armë dhe material luftarak. Qeveria shqiptare vendosi të ndalonte zbarkimin e kësaj sasive armatimi.³⁷ Ky incident shënoi një çarje tjetër në marrëdhëniet e drejtuesve të “Komitetit të Kosovës” me drejtuesit e “Krahut Kombëtar” dhe veçanërisht me ministrin e Brendshëm, Ahmet Zogu.³⁸

Pas formimit të së ashtuquajturës “Parti Popullore” në vitin 1921, rolin kryesor politik brenda saj, e luajti një grup i kufizuar personash. Për këtë arsye, “Krahu Kombëtar” u quajt nga kundërshtarët politikë me emërtimin “Klika”. Drejtuesit e “Komitetit të Fshehtë” apo “Klikës” siç quhej nga kundërshtarët politikë ishin: Eshref Frashëri, Ahmet Zogu, Xhafer Ypi, Sotir Peci, Sejfi Vllamasi, Maliq Bushati, Bajram Fevziu,

³⁴ *Po aty*, f. 274.

³⁵ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri ...*, Tiranë: Neraida, 2000, f. 188-191.

³⁶ Ismail Strazimiri, *Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë (Kujtime historike për lëvizjen kombëtare në Qarkun e Dibrës)*, Tiranë: Naimi, 2010, f. 111-112.

³⁷ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri ...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 221-223.

³⁸ E. bej Vlora, *Kujtime (1885-1925) ...*, f. 477; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 205.

Maliq Frashëri, Xhavit Leskoviku, Kol Thaçi, Mustafa Maksuti dhe Rexhep Mitrovica. Vendimet më të rëndësishme merreshin nga Eshref Frashëri dhe anëtarët e tij më të ngushtë brenda “Klikës” dhe më pas paraqiteshin para partisë. Ndërkohë që në të gjithë prefekturat, nënprefekturat dhe krahinat e vendit ishin emëruar në detyra të rëndësishme anëtarë të betuar të “Klikës”.³⁹ Ndër këta drejtues, veçohej Eshref Frashëri, të cilin Mustafa Kruja e quante si “njeri mjaft ambicioz, pa zhurmë e pa reklamë, mjeshtër të intrigave, magjistar për politikanët e thjeshtë e syleshë dhe armik i çdo njeriu me vlerë që nuk arrinte ta hidhte në rrethin e tij”, ndërsa Faik Konica e cilësonte atë si “njeriu i natës”.⁴⁰ Kjo parti ishte për zgjedhjen e deputetëve që mbronin parimet e Kongresit të Lushnjës dhe që luftonin kundër elementëve italo-filë.⁴¹ Ky grupim përbëhej kryesisht nga nacionalistë të shtresës së mesme.

Kriza politike e dhjetorit 1921, tensionoi marrëdhëniet midis drejtuesve të “Klikës” dhe atyre të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Këto ngjarje nxitën të dyja palët kundërshtarë “të betoheshin se kishin për ta marrë shpagën për atë që u ishte bërë”.⁴² Marrëdhëniet mes dy grupeve politike u acaruan më shumë pas organizimit të Kryengritjes së marsit 1922. Pas shtypjes së dy rebelimeve në dhjetor 1921 dhe në mars 1922, ndikimi politik i A. Zogut në Shqipëri u bë i padiskutueshëm, pasi ai tregoi një energji të madhe për rivendosjen e rendit publik dhe ruajtjen e stabilitetit politik të shtetit shqiptar. Mirëpo, rritja e ndikimit të tij politik brenda vendit, u perceptua nga drejtuesit e opozitës si prirje autoritariste nga ana e A. Zogut.

Pas shtypjes së Kryengritjes së marsit 1922, drejtuesit e “Klikës” kuptuan se edhe brenda kësaj organizate, ata gjendeshin në një pozitë më të dobët politike përballë Ahmet Zogut. Flamurin e “opozitës së brendshme” kundër A. Zogut e mori Eshref Frashëri, synimi i të cilit ishte

³⁹ TNA, FO 371/ 7330. Telegram i Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 18 janar 1922; M. Kruja – P. P. Margjokaj OFM, *Letërkëmbim (1947-1958)* ..., dok. nr. 20, f. 74; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 116, 165.

⁴⁰ Letër e Mustafa Krujës për Stavro Skëndin, Ramleh, (Egjipt), 2 nëntor 1953, në *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, Tiranë: 1996, f. 116.

⁴¹ Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë: Botimet 55, 2006, f. 127; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 246; A. Mema, *Institucionet përfaqësuese në Shqipëri...*, f. 145.

⁴² “Si rodhi kryengritja në Shqipëri”, në *Shqipëria e Re*, nr. 75, Konstancë, 2 prill 1922, f. 1.

të merrte në duart e tij drejtimin politik të vendit, duke iu imponuar Kryeministrit Xhafer Ypi dhe ministrit të Brendshëm A. Zogu. Intrigat e E. Frashërit ishin të ngjashme me ato që kishte zhvilluar më herët, Aqif Pashë Elbasani. Duke parë qëndrimin e lëkundur të E. Frashërit, si dhe ndikimin e dobët të këtij të fundit në mesin e anëtarëve të “Krahit Kombëtar”, Ahmet Zogu vendosi të bashkëpunonte me Sejfi Vllamasin. Afrimi i A. Zogut me S. Vllamasin nxiti E. Frashërin të zhvillonte një fushatë të egër propagandistike kundër tyre. Ky qëndrim shkaktoi tensionimin e situatës brenda “Partisë Popullore”.⁴³

Konsulli britanik Robert Parr shprehej se “Klika zbuloi se ajo kishte humbur mbështetësit e saj në Veri, ndërkohë që po theksohej xhelozia e vjetër midis Veriut dhe Jugut. Përballë epërsisë së A. Zogut në administratën civile, në ushtri dhe xhandarmëri, vihej re se drejtuesit nga jugu i Shqipërisë, nuk mund të gjenin në radhët e tyre një lider përfaqësues konkurrues. Në këtë mënyrë për ta nuk pati zgjidhje tjetër, veçse të lejonin që A. Zogu të bëhej kryeministër i vendit. Për shkak të këtij kompromisi, Ahmet Zogu siguroi konsolidimin e fuqisë së tij politike në Shqipëri.”⁴⁴

Rrethanat që çuan në largimin e Ahmet Zogut nga “Klika” në vitin 1923

Shkëndija e parë që tensionoi marrëdhëniet e Ahmet Zogut me një pjesë të përfaqësuesve të “Klikës” u shfaq gjatë periudhës pranverë-verë të vitit 1923. Në vitin 1923, ministri britanik në Shqipëri, H. C. A. Evers, i kërkoi qeverisë shqiptare, miratimin e kontratës koncesionare me kompaninë “Anglo-Persian” në parlament. Kjo u bë shkak për thellimin e përçarjes mes anëtarëve të “Klikës”. Në mars të vitit 1921, qeveria e drejtuar nga Iljaz Vrioni kishte nënshkruar marrëveshjen e koncesionit me shoqërinë britanike “Anglo-Persian Oil”. Deputetët e opozitës u përpoqën me të gjitha mjetet për të zvarritur miratimin e kontratës me këtë shoqëri. Ata i kërkuan qeverisë që t’i detyronte përfaqësuesit e

⁴³ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 298.

⁴⁴ TNA, FO 371/ 8535. Konsulli britanik Robert Parr, për lordin Curzon, Durrës, 15 tetor 1923.

shoqërisë “Anglo-Persian” që të përmirësonin kushtet e ofertës, përderisa kompani të tjera të huaja kishin paraqitur oferta “më të favorshme”.⁴⁵

Gjatë viteve 1922-1923, qeveria e drejtuar nga A. Zogu ftoi disa herë për bisedime, drejtuesit e opozitës për të diskutuar mbi këtë çështje. Kryeministri A. Zogu mendonte se koncesioni i naftës nuk ishte thjesht një problem ekonomik ose financiar, por përbënte një çështje politike që lidhej me interesat jetikë të kombit. Ai u kërkoi drejtuesve të opozitës se nuk duhej kundërshtuar dhënia e koncesionit të naftës shoqërisë britanike “Anglo-Persian”, sepse shteti shqiptar kishte nevojë për mbështetjen politike të një fuqie të madhe si Britania e Madhe, për t’u mbrojtur nga rreziqet që mund t’i vinin nga shtetet fqinje. Për këtë arsye, ai kërkoi që të miratohej kontrata e koncesionit në favor të kompanisë “Anglo-Persian”.⁴⁶ Përfaqësuesit e qeverisë theksonin se kompania britanike duhej të kishte përparësi, pasi ajo ishte e para që kishte lidhur kontratën me qeverinë shqiptare. Në të kundërt, shteti shqiptar do të tregonte një mungesë serioziteti. Ky qëndrim do të ishte një fyerje personale për ministrin britanik në Shqipëri dhe një mosmirënjohje e popullit shqiptar ndaj Britanisë së Madhe.⁴⁷

Ali Këlcyra, një nga eksponentët kryesorë të opozitës, konfirmonte faktin se ministri britanik në Tiranë, Harry C. A. Eyers, u kishte kërkuar disa herë deputetëve të opozitës që të mos ndikoheshin nga qëndrimi i Fan Nolit dhe Luigj Gurakuqit, pasi “i pari është vegël e legatës dhe shoqërive amerikane, ndërsa i dyti, për arsye që dihen, shtyhet nga legata italiane”.⁴⁸ Ministri britanik u theksoi deputetëve të opozitës mendimin se, hyrja e kapitalit britanik në Shqipëri, përbënte një garanci për ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë. Sipas tij, qeveria italiane, e cila fshihej prapa këtyre manovrave, e kishte të qartë se sigurimi i koncesionit dhe ndërtimi i tubacionit naftës-jellës në Vlorë nga ana e kompanisë “Anglo-Persian”, përbënte pengesën më të madhe për realizimin e ëndrrës italiane, pushtimin e këtij qyteti.⁴⁹

Në të vërtetë, drejtuesit e opozitës e kundërshtonin këtë koncesion për arsye politike personale, pasi kishin bindjen se me këtë akt, A. Zogu synonte më tepër të forconte pozitën e tij politike në Shqipëri sesa të

⁴⁵ A. Këlcyra, *Shkrime për Historinë e Shqipërisë...*, f. 94.

⁴⁶ *Po aty*, f. 93-94.

⁴⁷ *Po aty*, f. 94-95.

⁴⁸ *Po aty*, f. 97.

⁴⁹ *Po aty*.

mbronte interesat e shtetit shqiptar.⁵⁰ Në mesin e deputetëve të opozitës qarkullonte mendimi i përhapur nga ministri i Punëve Botore, Spiro Koleka, se kompania “Anglo-Persian” kishte vënë në dispozicion të “Partisë Popullore”, një shumë prej një milion franga ar, nëse i jepej koncesioni i naftës me kushtet e ofruara prej saj. Ministri i Arsimit, Rexhep Mitrovica, i kishte pohuar S. Kolekës se Kryeministri A. Zogu dhe shumica e anëtarëve të qeverisë ishin të mendimit që koncesioni duhej t’i jepej shoqërisë britanike. Prandaj, R. Mitrovica i kishte kërkuar S. Kolekës që si drejtues i dikasterit që mbulonte çështjen e koncesionit të lartpërmendur, duhej të mbështeste këtë sugjerim ose të jepte dorëheqjen nga detyra.⁵¹

Drejtuesit e opozitës i rekomanduan S. Kolekës që të mos jepte dorëheqjen, por ta sfidonte Kryeministrin A. Zogu, duke i kërkuar rrëzimin e tij nga detyra e ministrit, përmes mocionit të mosbesimit në parlament. Qëllimi ishte që S. Koleka të mund të sensibilizonte opinionin publik shqiptar gjatë seancës parlamentare.⁵² S. Koleka ndoqi linjën e veprimit që i sugjeruan drejtuesit e opozitës. Ai zvarriti realizimin e kësaj detyre, pavarësisht insistimit të Kryeministrit A. Zogu. Në këto rrethana, A. Zogu i kërkoi atij të jepte dorëheqjen. Mirëpo, në vend të dorëheqjes, në prill të vitit 1923, ministri i Punëve Botore kërkoi zhvillimin e një interpelance parlamentare, me qëllim që t’i jepte mundësi opozitës që ta sulmonte qeverinë. Në fund të kësaj seance parlamentare, përmes procedurës së votimit, “Partia Popullore” e cila kishte shumicën e vendeve në parlament, rrëzoi nga detyra ministrin S. Koleka.⁵³

Me synim që t’i jepej sa më parë zgjidhje çështjes së koncesionit të naftës, në maj të vitit 1923, Sejfi Vllamasi u zgjodh ministër i Punëve Botore. Dokumentet britanike dëshmojnë se as Sejfi Vllamasi nuk pati vullnetin e duhur që marrëveshja koncesionare të paraqitej për votim në parlament. Ministri britanik H. C. A. Eyres konstatonte se gjatë sesionit të verës të Parlamentit Shqiptar në vitin 1923, A. Zogu tregoi një lloj

⁵⁰ TNA, FO 371/ 8531. Ekstrakt i letrës së E. H. Shearme, përfaqësues i kompanisë “Anglo-Persian Oil” për Foreign Office, 12 dhjetor 1922; A. Këlcyra, *Shkrime për Historinë e Shqipërisë...*, f. 95.

⁵¹ A. Këlcyra, *Shkrime për Historinë e Shqipërisë...*, f. 100-101.

⁵² *Po aty*, f. 100-101.

⁵³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Periudha e Pavarësisë (28 nëntor 1912 - 7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 212; A. Këlcyra, *Shkrime për Historinë e Shqipërisë...*, f. 94.

dobësie dhe mbajti një pozicion të tërhequr kundrejt grupit kundërshtar brenda radhëve të “Klikës”. Kjo u reflektua edhe në zvarritjen e miratimit nga Parlamenti Shqiptar të koncesionit të naftës të arritur mes qeverisë shqiptare dhe kompanisë britanike “Anglo-Persian Oil”.⁵⁴ Në këtë mënyrë, miratimi i marrëveshjes koncesionare u la qëllimisht për t’u miratuar nga Asambleja e ardhshme Kushtetuese.

Megjithëse kishte shumicën dërmuese në parlament, qeveria e A. Zogut hezitoi ta miratonte kontratën koncesionare, pa pëlqimin e opozitës.⁵⁵ Në këtë drejtim, me sa duket ndikoi presioni politik i ushtruar nga legatat e huaja në Shqipëri, qëndrimi i tërhequr i disa deputetëve të mazhorancës, si dhe dyshimi i A. Zogut për leverdinë ekonomike të këtij koncesioni.⁵⁶

Gjatë verës së vitit 1923, shërbimet sekrete britanike informonin se krahas grupeve opozitare brenda vendit, nën drejtimin e ish anëtarit të “Klikës” Aqif Pashë Elbasanit, ishte formuar një komitet revolucionar në Vjenë, i cili kishte për qëllim, përmbysjen me forcë të qeverisë së Ahmet Zogut. Ky grup politik synonte që pas rrëzimit nga pushteti të Ahmet Zogut, të krijohej një qeveri e re nën drejtimin e Aqif Pashës dhe Hasan Prishtinës. Komiteti pretendonte se kishte mbështetjen e 30 deputetëve në Parlamentin Shqiptar. Drejtuesit e këtij komiteti kishin ngarkuar Fan Nolin si përfaqësuesin e tyre kryesor në Tiranë. Zija Dibra ishte ngarkuar me detyrën e organizatorit ushtarak dhe të ekspertit për çështjet e jashtme, ndërsa Irfan Bej Ohri ishte ngarkuar me detyrën e ekspertit për çështjet ekonomike.⁵⁷

Gjatë kohës kur Ahmet Zogu si anëtar i “Klikës” mbante postet e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të Kryeministrit, ai u përpoq të punonte me përkushtim, për stabilizimin e shtetit shqiptar, duke i bërë shërbime të mëdha atdheut.⁵⁸ A. Zogu synoi të kënaqte ambiciet e tij politike, por në të njëjtën kohë edhe t’i shërbente vendit në mënyrë legjitime. Qeveria e Ahmet Zogut, pati arritje në drejtim të forcimit të

⁵⁴ TNA, FO 371/ 8535. H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 26 gusht 1923.

⁵⁵ A. Këlcyra, *Shkrime për Historinë e Shqipërisë...*, f. 94; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. II (1920-1924), Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2019, f. 198.

⁵⁶ TNA, FO 371/ 8535. Robert Parr për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 15 tetor 1923; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX ...*, vëll. II, f. 200.

⁵⁷ TNA, FO 371/ 8535. Informacion i S. I. S. i Ministrisë së Luftës për Foreign Office, 20 korrik 1923.

⁵⁸ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri ...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 310.

autoritetit të qeverisë brenda vendit; në përmirësimin e imazhit të shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare; në vendosjen e marrëdhënieve të Shqipërisë me shtetet fqinje; në mbrojtjen e interesave kombëtarë gjatë caktimit të kufijve të Shqipërisë. Mirëpo, grupi i opozitës dhe disa përfaqësues të “Klikës” nuk i pëlqyen sukseset e arritura nga Ahmet Zogu. Për të paralizuar veprimet e qeverisë, ata filluan një luftë të ashpër politike në parlament kundër saj.⁵⁹

Drejtuesit e opozitës këmbëngulnin në kërkesën për thirrjen e Asamblesë Kushtetuese, e cila do të përcaktonte formën e regjimit të shtetit shqiptar. Në të vërtetë, me këtë veprim politik synohej që të krijohesh një fushë më e gjerë veprimi, për përhapjen e propagandës së tyre në të gjithë vendin. E vetmja shpresë që u kishte mbetur kundërshtarëve të qeverisë për të marrë pushtetin, ishte që të fitonin shumicën e vendeve në parlament.⁶⁰

Ahmet Zogu pranoi kërkesën e opozitës për zhvillimin e zgjedhjeve për në Asamblesë Kushtetuese. Ai vendosi të merrte këtë vendim, kur pa se grupi i kundërshtarëve të tij brenda “Klikës”, po forcohej gjithnjë e më shumë. Në gusht të vitit 1923, parlamenti u thirr në një seancë të jashtëzakonshme, gjatë së cilës u shqyrtua projektligji për zgjedhjet i paraqitur nga qeveria. Pas shqyrtimit të tij nga deputetët, më 30 shtator, parlamenti miratoi ligjin për zgjedhjet e anëtarëve të Asamblesë Kushtetuese, të cilat do të përfundonin më 27 dhjetor 1923.

Në prag të zgjedhjeve për në Asamblesë Kushtetuese, Ahmet Zogu hartoi planin e veprimit. Fatin e karrierës së tij politike, ai ia besoi rezultatit të zgjedhjeve të ardhshme. A. Zogu kishte bindjen se mbështetësit e tij nuk do ta braktisnin atë në këtë moment të vështirë. Gjatë një bisede konfidenciale me ministrin britanik Eyres, ai u shpreh se në rast se do të humbiste këto zgjedhje, do të tërhiqej përkohësisht nga politika dhe do të shkonte në Paris dhe Londër, që t’i kushtohej mësimi të gjuhës frënge dhe angleze. Në fakt, shërbimet sekrete britanike raportonin se “një numër i madh njerëzish preferojnë personalitetin e A. Zogut. Ai mbetet njeriu më i fortë në Shqipërinë e sotme”.⁶¹

⁵⁹ Xhemal Kusi, *Shqipëria në vitet 1912-1944 (Kujtime)*, përgatitur për botim nga dr. Hasan Bello, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet albanologjike, 2020, f. 278-279.

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ *TNA*, FO 371/ 8535. H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 26 gusht 1923.

Në fund të shtatorit 1923, situata politike brenda “Klikës” u përkeqësua. Për shkak të rritjes së ndikimit të A. Zogut në vend, jo vetëm opozita shqiptare por edhe “Klika” e ndezi më shumë atmosferën politike në vend. Kundërshtarët politikë brenda “Klikës” mendonin se Ahmet Zogu kontrollonte jo vetëm këtë organizatë të fshehtë, por edhe “Partinë Popullore”. Rexhep Mitrovica, Sejfi Vllamasi, Bedri Pejani dhe Ismail Haki Tatzati, drejtues të rëndësishëm të “Klikës” dhe mazhorancës politike u kthyen në një opozitë të brendshme ndaj kryeministrit. Ata e akuzuan A. Zogun për politikë filojugosllave dhe për dështim në reformimin e administratës shtetërore. Në këto rrethana, Ahmet Zogu vendosi të bashkëpunonte me Eshref Frashërin dhe ta përdorte këtë të fundit kundër tyre. Me këtë veprim, ai synoi të neutralizonte kundërshtarët e tij politikë brenda organizatës së “Klikës”. Në prag të zgjedhjeve, grupi kundërshtar i Zogut synonte formimin e një qeverie të re, në të cilën, Bedri Pejanit t’i jepej detyra e ministrit të Brendshëm, ndërsa Ismail Haki Tatzati t’i jepej ajo e ministrit të Luftës. Rikompozimi i qeverisë synonte dobësimin e pushtetit politik të Ahmet Zogut, pasi tashmë, kundërshtarët e tij brenda “Klikës” nuk ishin të sigurt për zgjedhjen e tyre si deputetë.⁶²

Në këtë periudhë, grupi kundërshtar i A. Zogut hartoi planin për rrëzimin e qeverisë së drejtuar nga A. Zogu. Sipas këtij plani, Ismail Haki Tatzati dha dorëheqjen nga detyra e ministrit të Luftës, me pretekstin se ai nuk gëzonte mbështetjen e qeverisë. Sapo Ismail H. Tatzati dha dorëheqjen, gjashtë deputetë të tjerë u larguan nga grupi i shumicës parlamentare, duke u bashkuar me grupin e ish “Bashkimit të Shenjtë” në opozitë. Opozita e paraqiti Ismail Haki Tatzatin si “viktimë” e luftës brenda “Klikës” dhe si “dëshmor” i idealit të lartë kombëtar. Ajo i kërkoi shumicës parlamentare që ta rrëzonin Kryeministrin A. Zogu, përmes një mocioni votëbesimi në parlament.⁶³

Pavarësisht situatës së tensionuar që u krijua nga opozita në parlament, e cila akuzoi dhe stigmatizoi kryeministrin me gjithfarë fjalësh, A. Zogu doli fitues, duke siguruar shumicën e votave gjatë

⁶² Mihal Grameno, *Kryengritja Shqiptare*, Vlorë: G. Direttore, 1925, f. 180; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 322.

⁶³ TNA, FO 371/ 8536. Raport i përgjithshëm mbi Shqipërinë për vitin 1923, hartuar nga H. C. A. Eyres për Kryeministrin britanik MacDonald, Durrës, 9 shkurt 1924; Kristo Dako, *Shënime historike nga jeta dhe veprat e N.M.T. Zogu I – Mbret’ i Shqiptarvet*, Tiranë: Kristo Luarasi, 1937, f. 117.

procesit të votëbesimit.⁶⁴ Mirëpo, gjatë periudhës së verës, dukej qartë se grupi i vogël i deputetëve të opozitës, demonstroi një agresivitet të hapur ndaj tij, të cilin nuk do të kishte guxuar ta provonte disa muaj më parë.⁶⁵

Intriga politike e drejtuesve të “Klikës” në bashkëpunim me opozitën dështoi për shkak të qëndrimit të vendosur që mbajti pjesa tjetër e “Partisë Popullore”; kundërshtimit nga A. Zogu të kërkesës për votëbesimin e qeverisë në parlament; dhe refuzimit të Sejfi Vllamasit për të pranuar postin e ministrit të Punëve të Brendshme. A. Zogu deklaronte se të gjitha këto vështirësi me të cilat ishte ndeshur kohët e fundit, vinin për shkak se ai kishte refuzuar të pranonte diktatin e “Klikës”. Diplomatët britanikë theksonin se A. Zogu shfaqti një guxim të madh për ta çliruar veten nga dominimi i kësaj organizate të fshehtë, e cila tashmë rrezikonte të ardhmen e Shqipërisë si dhe po pengonte realizimin e synimeve të tij të mira në favor të stabilitetit të vendit.⁶⁶

Në këtë periudhë, A. Zogu gjendej i bllokuar politikisht, prandaj ai dëshironte ta shpartallonte “Klikën”, përpara se ajo ta godiste atë.⁶⁷ Ai arriti në përfundimin se për shkak të përçarjes së brendshme, “Klika” nuk mund të funksiononte më si një organizatë politike. Për këtë arsye, ai vendosi të shkëputej dhe ta çlironte veten tërësisht nga diktati i saj.⁶⁸ Me intuitën dhe forcën e karakterit të tij, A. Zogu e kuptoi qartë se në të ardhmen do ta kishte të pamundur të ndiqte një rrugë të pavarur brenda “Klikës”. Për shkak se disa drejtues të “Klikës” nuk dëshironin praninë e tij, ai vendosi që të largohej gradualisht dhe në mënyrë paqësore nga grupi i “Klikës” dhe të ndiqte një rrugë të pavarur.⁶⁹

A. Zogu nuk doli hapur kundër kundërshtarëve të tij brenda “Klikës”, pasi ishte i bindur se ai ende nuk kishte konsoliduar pozitën e tij politike brenda vendit si dhe ishte i ndërgjegjshëm për faktin se të dyja grupet kundërshtarë tashmë të krijuara brenda “Partisë Popullore” kishin një ndikim thuajse të barabartë në mesin e shqiptarëve. Për arsyet e

⁶⁴ Xh. Kusi, *Shqipëria në vitet 1912-1944...*, f. 281.

⁶⁵ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. II, f. 200.

⁶⁶ TNA, FO 371/ 8535. H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 26 shtator 1923.

⁶⁷ Jason Tomes, *King Zog: Self-Made Monarch of Albania*, Sutton: The History Press, 2008, p. 59; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. II, f. 200.

⁶⁸ TNA, FO 371/ 8535. H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 27 tetor 1923.

⁶⁹ *Po aty*, FO 371/ 8536. Raport i përgjithshëm mbi Shqipërinë për vitin 1923 i H. C. A. Eyres për Kryeministrin britanik MacDonald, Durrës, 9 shkurt 1924.

mësipërme, ai ishte i bindur se, nëse do t'i kundërvihet grupimit kundërshtar, kjo mënyrë veprimi, mund të çonte në një luftë civile, e cila do të sillte rrënimin e shtetit, si dhe do t'u shkaktonte vuajtje dhe pasoja të rënda njerëzve të thjeshtë.⁷⁰

Në fillim të fushatës së zgjedhjeve për në Asamblenë Kushtetuese, ndërmjet Sejfi Vllamasit dhe Ahmet Zogut u arrit një marrëveshje verbale, sipas së cilës deri në përfundim të zgjedhjeve, duhej të ruhej *status quo*-ja në administratën shqiptare.⁷¹ Mirëpo, gjatë fushatës elektorale, majori Shefqet Korça, komandant i Përgjithshëm i xhandarmërisë shqiptare dhe një nga anëtarët kryesorë të “Klikës” doli hapur kundër A. Zogut. Ai deklaroi se nuk do t'u bindej urdhrave të Kryeministrit Ahmet Zogu. Në të njëjtën kohë, ai u dërgoi udhëzime oficerëve vartës, që të bënin të gjitha përpjekjet për të penguar fitoren e Ahmet Zogut në zgjedhje.⁷² Ndërkohë, kolonel Ismail H. Tatzati në bashkëpunim me major Shefqet Korçën dhe disa oficerë të tjerë, planifikuan organizimin e një atentati ndaj A. Zogut, gjatë ceremonisë që pritej të mbahej më 28 nëntor 1923, me rastin e festës së Pavarësisë së Shqipërisë.⁷³ Synimi i tyre ishte vrasja e A. Zogut dhe formimi i një qeverie të drejtuar nga ushtarakët.

Kryeministri Ahmet Zogu arriti ta zbulonte këtë komplot. Ai i kërkoi Këshillit të Naltë, largimin e Shefqet Korçës nga detyra që mbante dhe zëvendësimin e tij me major Banush Hamdinë. Kjo kërkesë shkaktoi përplasje ndërmjet anëtarëve të qeverisë.⁷⁴ Urdhri për shkarkimin e Shefqet Korçës u nënshkrua nga Regjenca, por ndërkohë u zvarrit zbatimi i tij. Me sa duket, dekreti nuk u vu në zbatim, për shkak se u shfaqën kundërshtime në mesin e anëtarëve të Këshillit të Ministrave.⁷⁵

Shefqet Korça u bëri thirrje mbështetësve të tij në radhët e trupave të xhandarmërisë si dhe popullsisë së krahinave të jugut të vendit që të

⁷⁰ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri ...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 310.

⁷¹ TNA, FO 371/ 8535. Robert Parr për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 1 dhjetor 1923; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 340-345.

⁷² *Po aty*.

⁷³ TNA, FO 371/ 8535. Telegram i Robert Parr për Foreign Office, Durrës, 22 nëntor 1923.

⁷⁴ *Bisedimet e Këshillit Kombtar*, Tiranë: Nikaj, 1922, f. 866, 872; Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, përkthyer nga Kujtim Ymeri, Tiranë: Dituria, 2005, f. 320-321; K. Dako, *Shënime historike nga jeta dhe veprat e N.M.T. Zogu I...*, f. 118.

⁷⁵ Xh. Kusi, *Shqipëria në vitet 1912-1944...*, f. 282.

bashkoheshin kundër A. Zogut. Në horizontin shqiptar të asaj periudhe u shfaq rreziku i fillimit të një lufte të brendshme civile. Përfaqësuesit e bashkisë së Tiranës zhvilluan një mbledhje, gjatë së cilës, shumica e tyre vendosi që “nëse shtrohej çështja e luftës midis gegëve* dhe toskëve*, ata do ta konsideronin veten gegë”.⁷⁶

Sejfi Vllamasi dhe Rexhep Mitrovica i kërkuan Ahmet Zogut që të mos ekzekutonte urdhrin për shkarkimin e Shefqet Korçës, derisa ata të ktheheshin nga Korça, ku gjendeshin në kuadër të fushatës elektorale. Sapo u kthyen në Tiranë, ata i kërkuan A. Zogut të jepte dorëheqjen si dhe e kërcënuan atë se, nëse përpqej të vepronte kundër Sh. Korçës, apo ndonjë oficeri tjetër të ushtrisë, do të tërhiqeshin nga qeveria. Regjenti Sotir Peci, ministri i Luftës, Mustafa Aranitasi dhe ai i Drejtësisë, Milto Tutulani, deklaruan se edhe ata do të jepnin dorëheqjen, nëse A. Zogu vepronte kundër Sh. Korçës. Në fund të takimit, të dy drejtuesit e “Klikës” i paraqitën A. Zogut tri propozime si zgjidhje për daljen nga kriza: 1. Dorëheqjen e qeverisë; 2. Thirrjen e parlamentit të shpërndarë; 3. Largimin e tij nga detyra e ministrit të Punëve të Brendshme deri në mbarim të zgjedhjeve dhe emërimin në vend të tij të Sejfi Vllamasit.⁷⁷

Për të larguar çdo lloj dyshimi, i cili mund të sillte probleme në zgjedhjet politike që mbaheshin në vend, Ahmet Zogu u hoq sikur pozita e tij ishte dobësuar përballë forcimit të kundërshtarëve të tij politikë. Ai pranoi të jepte dorëheqjen nga detyra e ministrit të Punëve të Brendshme, por me kusht që drejtimi i këtij dikasteri të mbahej me rotacion gjatë periudhës së zgjedhjeve. Sipas këtij parimi, çdo javë do ta merrte këtë post një ministër i qeverisë në detyrë. Në fillim, këtë detyrë do ta mbante Sejfi Vllamasi, ministër i Punëve Botore. Ky kompromis politik ishte e vetmja mënyrë për të kënaqur “Klikën”.⁷⁸

* Me këtë emërtim, nënkuptohej grupi i mbështetësve të Ahmet Zogut, të cilët ishin me origjinë kryesisht nga Shqipëria e Veriut dhe Shqipëria e Mesme. Pra, nga viset shqiptare mbi lumin Shkumbin.

* Me këtë emërtim nënkuptohej grupi i komplotistëve, i drejtuar nga kolonel Ismail H. Tatzati dhe major Shefqet Korça, të cilët ishin me origjinë kryesisht nga Shqipëria e Jugut. Pra, nga viset shqiptare poshtë lumit Shkumbin.

⁷⁶ TNA, FO 371/ 8535. Robert Parr për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 1 dhjetor 1923; Bernd Jurgen Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, përkthyer nga Krenar Hajdëri, botim i tretë në shqip, Tiranë: Çabej, 2004, f. 65-66.

⁷⁷ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 337-238.

⁷⁸ TNA, FO 371/ 8535. Robert Parr për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 1 dhjetor 1923; M. Grameno, *Kryengritja Shqiptare...*, f. 180.

Burimet arkivore britanike dëshmojnë se, A. Zogu fillimisht mendoi të përdorte forcën, që ta çlironte veten dhe vendin nga ankthi i “Klikës”. Ai kishte në dispozicion forca qeveritare besnike ndaj tij, me të cilat mund ta shtypte lëvizjen e ushtarakëve dhe të dënonte ashpër organizatorët e këtij “grushti shteti”. Mirëpo, kësaj here, A. Zogu zgjodhi alternativën e “veprimit paqësor”, të cilën me sa duket, ia rekomandoi ministri britanik H. C. A. Eyres. Në këto kushte, Ahmet Zogu vendosi të mos përdorte forcën, duke tërhequr urdhrin për shkarkimin e Sh. Korçës. Me sa duket, A. Zogu mbajti këtë qëndrim nisur nga disa faktorë. Ai gjykoi se do të ishte më e përshtatshme që të ndërmernte veprime graduale kundër oficerëve dhe funksionarëve kundërshtarë të tij. A. Zogu ndoqi rrugën e kompromisit, me qëllim që të mos prishej *status-quo*-ja gjatë zgjedhjeve, të ruhej stabiliteti i brendshëm i vendit dhe të punonte për të ardhmen, duke ndjekur rrugën konstitucionale.⁷⁹

Në përcaktimin e këtij qëndrimi, Ahmet Zogu natyrisht që mori në konsideratë edhe faktorë të tjerë. *Së pari*, ai e kishte të qartë se shumica e oficerëve të përfshirë në komplotin kundër tij, ishin oficerë me grada të larta. Sipas legjislacionit shqiptar, gjykimi i tyre ishte kompetencë e eprorëve të tyre ushtarakë, pra, i organizatorëve të komplotit. *Së dyti*, A. Zogu e kishte të pamundur të dënonte ministrat e përfshirë në këtë konspiracion, pasi ata mund të gjykoreshin dhe shkarkoreshin vetëm nga parlamenti. Mirëpo, Zogu nuk ishte i sigurt nëse aty kishte shumicën e votave. *Së treti*, thirrja e parlamentit që tashmë ndodhej i shpërndarë, tregonte dobësinë e tij si dhe do të shtynte procesin e zgjedhjeve. *Së katërti*, mbështetësit e “Klikës” kishin siguruar mjete financiare nga Turqia dhe Italia, si dhe kishin arritur të depërtonin gjerësisht në radhët e administratës dhe të ushtrisë shqiptare. Në këto kushte, A. Zogu arriti në përfundimin që, edhe nëse goditja ndaj kundërshtarëve të tij politikë do të kishte sukses, ai do të akuzohej si “diktator”.⁸⁰

Përfaqësuesit e Britanisë së Madhe, SHBA, Italisë dhe Jugosllavisë, të cilët ndiqnin me kujdes zhvillimet politike në Shqipëri, bënë të ditur që në rast se Ahmet Zogu përmbyshej me dhunë nga pushteti, qeveria

⁷⁹ TNA, FO 371/ 8535. Robert Parr për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 1 dhjetor 1923.

⁸⁰ *Po aty*.

revolucionare që do të merrte drejtimin e vendit nuk do të njihej prej tyre.⁸¹

Pas dështimit të komplotit, pozita e Ahmet Zogut u forcua. Diplomati britanik Robert Parr mendonte se në këtë kohë, shumica e banorëve të krahinave të Shqipërisë së Mesme dhe atyre të Veriut, dëshironin që Ahmet Zogu të ishte në krye të qeverisë shqiptare. Solidariteti i tyre ndaj Zogut, vinte kryesisht për shkak të reputacionit të tij personal. Malësorët e shihnin A. Zogun si “mbrojtës ndaj drejtuesve të pabesë të ‘Klikës’”. Për këtë arsye, ata ishin të gatshëm ta ndihmonin atë në rast nevoje. Për më tepër, te banorët e disa krahinave të Shqipërisë ishte krijuar përshtypja se A. Zogu “po punon krah për krah me Britaninë e Madhe”. Imazhi se A. Zogu gëzonte mbështetjen e kësaj fuqie të madhe dhe me reputacion te shqiptarët, e kishte forcuar më tepër pozitën e tij politike brenda vendit.⁸²

Nga krahina të ndryshme të vendit, atij i erdhën mesazhe mbështetjeje, ku theksohej se nëse oficerët e “Klikës” do të ndërmerrenin një grusht shteti, ata ishin të gatshëm t’i vinin në ndihmë. Një numër oficerësh të rinj i deklaruan ministrin të Luftës se, ata nuk do t’u bindeshin urdhrave të eprorëve të tyre, nëse ato synonin të nxisnin rebelimin kundër qeverisë shqiptare. Ndërkohë, në Tiranë arritën dy regjentët e tjerë, Gjon Çoba dhe Xhafer Ypi, të cilët bënë për vete regjentin e tretë, Refik Toptani dhe së bashku i dolën në krah Ahmet Zogut.⁸³

Ngjarjet politike të vitit 1923, dëshmuar se drejtuesit e “Klikës” synonin ta përdornin Ahmet Zogun si “mashë”, për të vendosur kontrollin e tyre brenda “Klikës” dhe në të gjithë vendin. Mirëpo, ishte A. Zogu që arriti të shfrytëzonte mjeshtërisht kontradiktat mes Eshref Frashërit dhe Sejfi Vllamasit dhe “i bëri ata vegla të bindura në parlament dhe në aparatin shtetëror...”⁸⁴

⁸¹ *Po aty*, Miles W. Lampson për Robert Parr në Durrës, F.O., 17 dhjetor 1923; B. J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri...*, f. 67.

⁸² TNA, FO 371/ 8535. Robert Parr për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 27 tetor 1923.

⁸³ *Po aty*, FO 371/ 8535. Robert Parr për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 1 dhjetor 1923; M. Grameno, *Kryengritja Shqiptare...*, f. 180.

⁸⁴ M. Kruja – P. P. Margjokaj OFM, *Letërkëmbim (1947-1958)...*, dok. nr. 20, f. 75; E. bej Vlora, *Kujtime (1885-1925)...*, f. 462; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 314.

Nacionalizmi shqiptar u detyrua të tregohej më liberal kundrejt nacionalizmave fqinj, për shkak se ai ishte më i dobët në raport me fqinjët. Mirëpo, ai nuk kultivoi të njëjtën frymë tolerance brenda klasës politike dhe vetë shoqërisë shqiptare.⁸⁵ Sejfi Vllamasi mendonte se gjatë viteve 1920-1923, nuk u arrit ndonjë situatë ideale në zhvillimin e brendshëm të shtetit shqiptar, për shkak se disa drejtues të “Klikës”, u kthyen në shkatërruesit e vërtetë të rendit publik dhe të atdheut. Sipas tij, krahas “Klikës”, edhe opozita pati përgjegjësi për këtë situatë. Përmes shpifjeve, intrigave politike dhe taktikave sabotuese, ajo përgatiti terrenin për shpërbërjen e grupimit politik kombëtar që u krijua nga Kongresi i Lushnjës. Përpjekjet e bëra nga Ahmet Zogu, për krijimin e këtij grupimi, u shoqëruan me sulme politike ndaj tij, nga disa prej drejtuesve të “Klikës”. Në këto rrethana, ishte e qartë se Ahmet Zogu nuk mund të qëndronte më tej duarkryq. Për të shpëtuar jetën por edhe për të realizuar synimet e tij politike, ai ishte i detyruar të krijonte një parti të re politike ose të largohej nga Shqipëria.⁸⁶

Gjatë fushatës së zgjedhjeve për në Asamblenë Kushtetuese, Ahmet Zogu nuk krijoi një parti të mirëfilltë politike, me të cilën do t’u drejtohej zgjedhësve. Ai iu drejtua atyre përmes një shpalljeje personale, duke i kërkuar popullit të votonte për grupin e mbështetësve të tij.⁸⁷ Ahmet Zogu deklaroi se për interesat e vendit përparësi duhej të kishin disiplina dhe stabiliteti i brendshëm politik.⁸⁸ Ai mendonte se formimi i katër grupeve parlamentare që i emërtoi: grupi “mbretëror”, “republikan”, “liberal” dhe “konservator” kishin shkaktuar përçarjen politike të vendit. A. Zogu synonte krijimin e një partie të re politike, e cila të përbëhej nga mbështetësit e tij, të cilët do ta ndihmonin për hartimin e kushtetutës.⁸⁹

Gjatë periudhës së zgjedhjeve, Ahmet Zogu i kishte shprehur konsullit britanik R. Parr, mendimin e tij për mënyrën e drejtimit politik të Shqipërisë në të ardhmen. Në këndvështrimin e tij, deri në këtë periudhë, Shqipëria ishte drejtuar kryesisht nga bejlerët, kapedanët dhe

⁸⁵ TNA, FO 371/ 8536. Raport i përgjithshëm mbi Shqipërinë për vitin 1923, hartuar nga H. C. A. Eyres për Kryeministrin britanik R. MacDonald, Durrës, 9 shkurt 1924.

⁸⁶ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 344.

⁸⁷ A. Këlcyra, *Shkrime për Historinë e Shqipërisë...*, f. 102.

⁸⁸ Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit – Demokracia Shqiptare në vitet 1920-1924*, botim i dytë, përkthyer nga Lindita Bubësi, Tiranë: Albin, 2003, f. 69.

⁸⁹ TNA, FO 371/ 8535. Robert Parr për markezimin Curzon të Kedleston, Durrës, 27 tetor 1923.

bajraktarët, por tashmë çështja shtrohej: A ishte e mundur që edhe në të ardhmen, vendi të drejtohej nga i njëjti grup njerëzish? A. Zogu ishte i ndërgjegjshëm për faktin se nga momenti i Shpalljes së Pavarësisë, situata politike brenda vendit kishte evoluar aq shumë, sa Shqipëria nuk mund të kthehej në drejtimin e kundërt. Mirëpo, sipas A. Zogut, sistemi politik perëndimor nuk u përshtatej sa dhe si duhej, kushteve në të cilat ndodhej Shqipëria e viteve 1920. Vendi vazhdonte të drejtohej sipas modelit të institucioneve tradicionale vendëse dhe të mendësisë së vjetër politike të trashëguar të shqiptarët, për shkak se, modeli i huazuar nga vendet perëndimore, nuk ishte zbatuar në Shqipëri në mënyrën e duhur. Për të shmangur mungesën e stabilitetit politik brenda vendit, A. Zogu ishte i mendimit se krijimi i një parlamenti të përbërë nga dy dhoma, mund të përbënte një formë politike më të përshtatshme, për kushtet në të cilat ndodhej Shqipëria.⁹⁰

Ahmet Zogu mendonte se nga pikëpamja e zhvillimit kulturor dhe psikologjik, Shqipëria ishte e ndarë në tri zona kulturore dhe kjo përbënte një shqetësim të madh për mënyrën e qeverisjes së vendit. Sipas këndvështrimit të tij, qeverisja e Shqipërisë së Veriut duhej të mbështetej në modelin e traditës dhe të zakoneve të lashta të trashëguara brez pas brezi të banorët e këtyre viseve. Mirëpo, problem mbetej fakti se, shumica e prefektëve dhe e nënprefektëve të emëruar në këtë rajon ishin me origjinë nga viset jugore dhe ata ishin të papërshtatshëm për postet që mbanin. Pjesa më e madhe e këtyre funksionarëve ishin njerëz të shkolluar, që kishin njohuri mbi legjislacionin, por ata ishin “njerëz të vegjël” dhe të paaftë për të drejtuar malësorët. Në këto rrethana, A. Zogu mendonte të dërgonte me studime jashtë shtetit, një grup të rinjsh që rridhnin nga familjet e shquara dhe me ndikim në krahinat e Shqipërisë së Veriut, të cilët synonte t’i aktivizonte më vonë në drejtimin e administratës së shtetit shqiptar. Për këtë qëllim, me shpenzimet e tij, ai kishte filluar të dërgonte për të studiuar disa të rinj shqiptarë nga këto vise. A. Zogu mendonte se derisa këta të rinj do të arrinin të përgatiteshin në shkollat perëndimore, ai ishte i detyruar t’i mbante etërit e tyre të pashkolluar në postet e nënprefektëve dhe në detyra të tjera të rangjeve më të ulëta shtetërore.⁹¹

⁹⁰ *Po aty.*

⁹¹ *Po aty.*

Lidhur me mënyrën e qeverisjes së Shqipërisë së Mesme, A. Zogu mendonte se, shumica e banorëve të këtij rajoni i bindeshin autoritetit të shtetit. Por, ai ishte i ndërgjegjshëm për faktin se këta banorë mund të lëkundeshin në bindjen e tyre ndaj shtetit, nëse drejtuesit e qeverive shqiptare përpiqeshin të luanin me idetë dhe besimin e tyre fetar.⁹²

Sipas Ahmet Zogut, vështirësia më e madhe për të, ishte gjetja e një mënyre më të përshtatshme qeverisjeje për banorët e Shqipërisë së Jugut. Ajo kushtëzohej nga tre faktorë kryesorë. *Së pari*, që nga në gjysma e parë e shek. XIX, kohë kur Reshid Pasha masakroi drejtuesit e familjeve të shquara në Shqipërinë e Jugut, ato nuk arritën të siguronin më pozitën e mëparshme drejtuese në këto vise. Mirëpo, pavarësisht se ndikimi politik i këtyre familjeve në mesin e popullsisë së Shqipërisë së Jugut po dobësohej gjithnjë, ata nuk kishin ndërmend të hiqnin dorë nga drejtimi i vendit. *Së dyti*, krahasuar me krahinat e tjera të Shqipërisë, në viset jugore kishte një numër më të madh njerëzish të arsimuar. Mirëpo, këta të fundit e kishin të vështirë të qeverisnin në të gjithë vendin, ndërkohë atyre nuk u pëlqente që Shqipëria të drejtohej nga të tjerët. *Së treti*, gjatë viteve të fundit, në krahinat e Jugut ishte rritur numri i të rinjve, të cilët pas një emigrimi të shkurtër në SHBA, riktheheshin në Shqipëri si “apostuj të demokracisë”. Natyrisht, këta të rinj kërkonin që të kishin zërin e tyre në çështjet e drejtimit politik të vendit.⁹³

Pavarësisht disa incidenteve të kufizuara, zgjedhjet për në Asamblenë Kushtetuese u zhvilluan sipas parashikimit. Një nga krerët e opozitës, Ali Këlcyra shprehet qartë se zgjedhjet për në Asamblenë Kushtetuese u mbajtën në liri të plotë, pasi edhe sikur të donte qeveria të ndërhynte në zgjedhje, kjo ishte e pamundur, sepse opozita ishte në këmbë. Sipas tij, nga këto zgjedhje dolën një grup asambleistësh, të cilët përfaqësonin tri rryma politike: 1. Grupi i deputetëve qeveritarë me në krye Kryeministrin A. Zogu; 2. Grupi i opozitës që i shpalli luftë të hapur grupit të A. Zogut; 3. Grupi i ashtuquajtur “konservator”, në të cilin bënin pjesë deputetë të cilët ishin kundër A. Zogut dhe opozitës. Asnjë nga të tri grupimet politike nuk siguroi shumicën e vendeve në Asamblenë Kushtetuese.⁹⁴ Ndërkohë, “Partia Popullore”, e cila në opinionin publik shqiptar njihej me emrin “Klika”, u diskreditua aq shumë nga propaganda

⁹² *Po aty.*

⁹³ *Po aty.*

⁹⁴ A. Këlcyra, *Shkrime për Historinë e Shqipërisë...*, f. 107-108.

e opozitës dhe largimi i A. Zogut prej saj, sa ajo u eliminua tërësisht nga skena politike shqiptare.⁹⁵ Në këto rrethana, vijoi të qëndronte në fuqi qeveria e drejtuar nga A. Zogu, i cili pas pak kohe, arriti të siguronte mbështetjen e deputetëve të grupit të tretë dhe në këtë mënyrë siguroi shumicën qeverisëse.

Vitet 1922-1923, u karakterizuan nga një atmosferë e zjarrtë e protagonizmit politik, e cila krijoi probleme të mëdha në funksionimin e shtetit shqiptar, të cilat patën pasoja të rënda për shqiptarët. Lufta për pushtet politik u kthye në një sëmundje kronike që la gjurmë të thella në mendësinë e shqiptarëve në procesin e shtetformimit dhe të unitetit të tyre kombëtar. Përfaqësuesit politikë nuk arritën të nxisnin si duhet te shqiptarët ndjenjën e solidaritetit dhe ta orientonin vëmendjen e tyre kryesisht në çështjet e zhvillimit të vendit. Përkundrazi, me veprimet e tyre, ata ndikuan që situata politike brenda vendit të bëhej më kaotike.⁹⁶

Mosmarrëveshjet e brendshme politike, mungesa e vizionit politik, lufta për pushtet dhe veprimtaria konspirative e “Klikës” në trupin e administratës së shtetit shqiptar ndikuan në ndërtimin e institucioneve dhe të një demokracie të brishtë në Shqipëri. Rivaliteti i shfaqur brenda “Klikës” ishte faktori kryesor që shkatërroi themelet e “Partisë Popullore”. Ato ishin një tregues i rëndësishëm për ngjarjet e rënda politike, të cilat do të ndodhnin më vonë në Shqipëri.⁹⁷

Nëse deri në vitin 1923, “Klika” dha një kontribut me rëndësi për ndërtimin e institucioneve të shtetit kombëtar, për dëbimin e trupave të huaja nga territori i Shqipërisë, në përmirësimin e imazhit të shqiptarëve dhe të shtetit të tyre në arenën ndërkombëtare, nga viti 1923, roli i saj jo vetëm që u zbeh, por ajo nxiti më shumë, destabilizimin e brendshëm politik të shtetit shqiptar. Kjo mënyrë qasjeje e klasës politike, e la shtetin shqiptar të ekspozuar ndaj kërcënimeve dhe ndërhyrjeve të vazhdueshme nga ana e shteteve fqinje. Padyshim që në këtë drejtim, edhe “Klika” pati një pjesë të përgjegjësisë.

⁹⁵ *Po aty*, f. 102.

⁹⁶ TNA, FO 371/ 8531. Raport final i Komisionit Hetimor të Këshillit të Lidhjes së Kombeve mbi Shqipërinë, Gjenevë, 6 prill 1923.

⁹⁷ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 298.

*S u m m a r y*THE ORIGIN OF THE SECRET POLITICAL ORGANIZATION "NATIONAL WING"
(CLIQUE) – THE LEAVING OF AHMET ZOGU FROM THIS ORGANIZATION

The secret political organization "League for the Throne of the Fatherland" was founded in Durrës, on June 28, 1914. Later, this nationalist organization received the name "National Wing" or "Clique". Its purpose was to save Albania from the intentions of neighboring countries.

Ahmet Zogu's cooperation with this political organization began in 1917 and intensified in the spring of 1919. To realize their goals, the "National Wing" leaders elected A. Zogu from Northern Albania. The organization "National Wing" became the initiator and organizer of the National Congress of Lushnja in 1920.

The aggravation of Ahmet Zogu's relations with a part of the representatives of "Clique" started during the spring-summer period of 1923. The political opponents of A. Zogu within the political majority thought that now A. Zogu controlled not only "Clique", but also the "People's Party". They turned into internal opposition to Prime Minister Ahmet Zogu.

In September 1923, A. Zogu concluded that a "Clique" could no longer function as a political organization. For this reason, he decided to break away gradually and peacefully to leave the "Clique" group, freeing himself completely from its dictation. In these circumstances, A. Zogu accepted the request of the opposition for the elections to the Constituent Assembly.

The political events of 1923, proved that the leaders of "Clique" had intended to use Ahmet Zogu as a "fire-iron", to establish their political control within this secret organization and throughout the country. However, A. Zogu managed to skillfully exploit the contradictions between Eshref Frashëri and Sejfi Vllamasi, turning the main leaders of "Clique" into "obedient tools" in Albanian Parliament and the state apparatus.

Until the summer of 1923, "Clique" made an important contribution to the construction of the Albanian state. Subsequently, its role not only faded, but it fostered the internal political destabilization of Albania. This approach by the Albanian political class left the Albanian state weak and exposed to constant threats and interventions by neighboring countries. In this regard, "Clique" also had a part of the responsibility.